

PËRMBLEDHJE E ANALIZAVE VJETORE TË PUNËS SË VITIT 2020 TË KONTROLLIT TË LARTË TË SHQIPËRISË

Në datën 10 mars 2021, në mjediset e Kontrollit të Lartë të Shtetit u zhvillua analiza vjetore e performancës së institucionit për vitin 2020.

Në hapje të këtij takimi Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, z. Arben Shehu theksoi se të gjithë jemi dëshmitarë që viti 2020 ishte një vit i trazuar dhe shumë i vështirë, në një situatë të pazakontë të pandemisë botërore COVID-19, e cila ashtu si në të gjitha institucionet e tjera publike brenda dhe jashtë vendit, ka ndikuar edhe në veprimtarinë e institucionit tonë.

Pavarësisht sfidave, Kontrolli i Lartë i Shtetit, si institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili auditon në përputhje me Kushtetutën, kuadrin ligjor, rregullator dhe manualet në fuqi, ka marrë të gjitha masat për të vijuar punën pa ndërprerje me përgjegjshmëri dhe rigorozitet duke arritur të plotësojë dhe zbatojë detyrimet kushtetuese.

Gjatë takimit u evidentua fakti se edhe gjatë vitit 2020, Kontrolli i Lartë i Shtetit si institucion i pavarur, i cili informon në vazhdimësi, dhe në mënyrë të paanshme Kuvendin e Shqipërisë, i ka përmbushur detyrimet kushtetuese.

Në funksion të mirëqeverisjes, KLSH-ja ka informuar Kuvendin përmes raporteve të cilat paraqesin rëndësi për taksapaguesit dhe publikun e gjerë. Konkretisht gjatë vitit 2020, Kontrolli i lartë i Shtetit i ka përcjellë Kuvendit të Shqipërisë 66 vendime dhe raporte për auditimet e kryera, si dhe në përmbushje të detyrimeve, KLSH ka informuar Kuvendin e Shqipërisë mbi statusin e implementimit të rekomandimeve të lëna në institucionet e audituara.

Në këtë kuadër, rezultatet e auditimeve të kryera gjatë vitit 2020, kanë evidentuar problematikat e menaxhimit të fondeve, asetëve dhe pasurisë publike, si dhe përgjegjësitë përkatëse nga zyrtarët e çdo niveli të qeverisjes qendrore, vendore dhe enteve në varësi të tyre.

Gjithashtu, KLSH gjatë veprimtarisë audituese, në mënyrë të vazhdueshme ka pasur qasjen që të nxisë dhe të thellojë transparencën, përgjegjshmërinë, llogaridhënien, forcimin e disiplinës fiskale dhe rritjen e efikasitetit në menaxhimin dhe përdorimin e burimeve publike me qëllim ofrimin e shërbimeve të përmirësuara dhe zhvillimin ekonomik të vendit.

Duke i kushtuar vëmendje të veçantë ruajtjes së qëndrueshmërisë në rezultatet e arritura, konkretizimit të qëllimeve strategjike, përmirësimit të kuadrit rregullator dhe metodologjik, optimizimit të kapaciteteve profesionale, si dhe përmirësimit të kanaleve të komunikimit dhe bashkëpunimit, veprimtaria e Kontrollit të Lartë të Shtetit edhe për vitin 2020, është konkretizuar në tre qëllime strategjike konkretisht:

1. Rritja e impaktit të punës audituese me fokus 6E-të (Efektiviteti, Eficiencia, Ekonomiciteti, Etika, Energjia dhe Mjedisi);
2. Optimizimi i kapaciteteve profesionale, aftësive audituese, procedurave të punës, logjistikës dhe funksioneve të tjera mbështetëse;
3. Përmirësimi i kanaleve të komunikimit dhe bashkëpunimit.

Në këtë kuadër, KLSH, duke ecur përkrah SAI-eve partnere, është përpjekur në mënyrë të vazhdueshme për rritjen e profesionalizmit auditues, në përshtatje me ritmin e zhvillimit ekonomik dhe social të vendit, si dhe të modernizimit të institucionit.

Në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit 2018-2022, KLSH-ja ka ndërmarrë veprime për të përmirësuar kapacitetin institucional, si dhe forcimin e ligjit organik.

Lidhur me rezultatet e veprimtarisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2020 si një vit i vështirë dhe i paprecedentë, ka vijuar puna audituese për përgatitjen e 145 raporteve të auditimit, nga të cilët janë evaduar 73 auditime.

Auditimet e evaduara përbëhen nga 5 auditime financiare me dhënie opinionit, 28 auditime përputhshmërie, 16 auditime rregullshmërie, 11 auditime tematikë, 9 auditime performance dhe 4 auditime të Teknologjisë së Informacionit.

Auditimet e kryera nga KLSH kanë përfshirë vlerësimin e aktivitetit ekonomik dhe financiar në 91 subjekte si institucione qendrore, ministri dhe agjenci (përfshirë drejtori qendrore dhe rajonale në varësi të tyre), njësi të vetëqeverisjes vendore (qarqe, bashki), drejtori të përgjithshme të administrimit fiskal, fonde speciale, si dhe shoqëri aksionare.

Janë evaduar auditimet e ushtruara në 76 subjekte, rezultatet e të cilëve kanë evidentuar shkelje me efekte të konsiderueshme në buxhetin e shtetit, lidhur me administrimin e të ardhurave; menaxhimin joefektiv në përdorimin e fondeve publike; keqadministrimin e pronës publike, e ndjekur nga paligjshmëritë në realizimin e procedurave të prokurimit publik dhe zbatimin e kontratave.

Duhet theksuar se me gjithë vështirësitë objektive të krijuara nga situata e pandemisë, KLSH është përpjekur maksimalisht të ruajë trendin në rritje të peshës specifike të auditimeve financiare dhe atyre të performancës ndaj totalit të auditimeve.

Kështu në vitin 2020 janë dhënë opinione financiare për 22 % të auditimeve nga 16 % në vitin 2019. Në 16 auditimet e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë klasifikuar si auditime të kombinuara janë dhënë opinione për pasqyrat financiare dhe përputhshmërinë për 12 auditime. Në këtë mënyrë KLSH synon zbatimin në vazhdimësi të rekomandimit të Komisionit Evropian në Raportet e Progresit për Shqipërinë për rritjen e përqindjes së auditimeve financiare dhe të performancës ndaj llojeve të tjera të auditimeve.

Rezultatet e punës audituese të vitit 2020 kanë pasur objektiv dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e gjendjes së institucioneve të audituara nëpërmjet masave organizative, si dhe identifikimin e shkeljeve me pasojë dëm ekonomik dhe/ose parregullsi/paligjshmëri me efekte negative në financat publike. Ndër treguesit kryesorë të performancës së aktivitetit të KLSH-së, për vitin 2020 përmendim:

- ✓ **Adresimin në total prej 1430 rekomandimeve**, nga të cilat: 29 janë propozime për përmirësime ligjore, 1107 masa organizative, dhe 294 rekomandime për masa disiplinore dhe administrative.
- ✓ **Shkelje me pasojë dëm ekonomik** - Parregullsi dhe shkelje financiare, në të ardhurat dhe në shpenzimet e kryera, me dëm ekonomik **në shumën totale rreth 2.2 miliardë lekë ose rreth 17.7 milionë euro**.
- ✓ **Parregullsitë dhe paligjshmëritë me efekte negative** - Shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e subjekteve të audituara, në shumën 85.9 miliardë

lekë (**ose afërsisht 694.1 milionë euro**) nga e cila: 11.4 miliardë lekë në fushën e të ardhurave (ose afërsisht **91.9 milionë euro**), dhe 74.5 miliardë lekë (**ose afërsisht 602.2 milionë euro**), në fushën e shpenzimeve.

Sa i takon **menaxhimit të financave publike**, edhe gjatë vitit 2020 KLSH ka vijuar të sjellë në vëmendje, risqet e identifikuar për miradministrimin e financave publike dhe zbatimin e kontrolleve të parashikuara të disiplinës fiskale. Nëpërmjet rekomandimeve të lëna, institucioni ka kërkuar adresimin e menjëhershëm dhe të kujdesshëm të mbajtjes në kontroll dhe monitorim të treguesve fiskalë dhe makro-ekonomikë, më konkretisht:

1. Në lidhje me raportimin e nivelit të defiçitit për vitin 2019.
2. Në lidhje me planifikimin më të drejtë të të ardhurave tatimore sipas zërave të vecantë dhe shpërndarjes së tyre në rajone në korelacion me grup-tatimpaguesit, kapacitetet dhe zhvillimet rajonale.
3. Në lidhje me një vlerësim më relevant dhe transparent të impaktit në të ardhurat tatimore i ndryshimeve të parashikuara në legjislacionin tatimor, në përputhje me parimet dhe rregullat fiskale.

Në lidhje me **auditimet financiare**, veprimtaria audituese e KLSH-së gjatë vitit 2020, është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit Financiar (ISSAI 2000-2899), si dhe Manualit të auditimit financiar, i cili gjithashtu është rishikuar dhe do të nisë zbatimin e plotë gjatë vitit 2021.

Gjatë vitit 2020, KLSH-ja ka kryer dhe evaduar 5 auditime financiare ose 7% ndaj totalit të auditimeve të evaduara, për të cilat janë dhënë 2 opinione të kualifikuar, 1 i pakualifikuar, 1 me theksim të çështjes dhe 1 opinion i kundërt.

Gjatë viti 2020, KLSH-ja ka kryer **28 auditime përputhshmërie**.

KLSH, duke qenë në sinkron dhe në zbatim të rekomandimeve të Komisionit Evropian për auditimin e jashtëm të sektorit publik të viteve të fundit ka synuar rritjen e përqindjes së numrit të **auditimeve të performancës ndaj auditimeve gjithsej**. Kështu gjatë vitit 2020 janë kryer dhe evaduar 9 auditime performance të kryera në 28 subjekte, të cilat përfaqësojnë 12.5 % të auditimeve gjithsej, kundrejt 11.4 % në vitin 2019.

Bashkëpunimi i KLSH-së në luftën kundër korrupsionit për vitin 2020 krahas nënshkrimit të marrëveshjeve specifike të bashkëpunimit, është intensifikuar nëpërmjet marrëdhënieve të bashkëpunimit me institucionet ligj-zbatuese si Prokuroria e Përgjithshme, Prokuroria Speciale, Byroja Kombëtare e Hetimit, SPAK etj.

Ngritja dhe forcimi i kapaciteteve institucionale ka vijuar duke u mbështetur në trajnimin e audituesve, konsideruar nga KLSH si një proces investimi strategjik i kohës, energjisë dhe burimeve, në përmirësimin e kapaciteteve audituese. Gjatë vitit 2020, për shkak të situatës së shkaktuar nga Covid-19, trainimet nga institucioni apo nga partnere brenda dhe jashtë vendit janë përshtatur dhe ofruar nëpërmjet platformave online, me qëllim përmbushjen e objektivave në lidhje me zhvillimin profesional.

Gjatë vitit 2020, KLSH i ka kushtuar vëmendje të veçantë çështjeve të komunikimit dhe të transparencës.

Kontrolli i Lartë i Shtetit është përpjekur të rrisë influencën dhe impaktin e auditimeve, duke zgjeruar bazën e përdoruesve, në mënyrë që gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e

auditimeve, t'i shërbejnë në mënyrë cilësore publikut, duke përdorur kanalet më efektive të komunikimit.

Komunikimi dhe bashkëpunimi me median vijon me të njëjtën frymë dhe intensitet duke rritur në këtë mënyrë transparencën e veprimtarisë së KLSH-së.

Edhe angazhimi i KLSH-së në aktivitete dhe botime për vitin 2020 nuk është ndërprerë ndonëse lindi nevoja e përshtatjes me rrethanat e krijuara nga pandemia. Në këto kushte, 6 botimet e KLSH-së, janë të publikuara në faqen online.

Gjatë vitit të shkuar ka filluar gjithashtu edhe pilotimi i këtyre manualeve, proces që po vijon edhe për vitin 2021, për të garantuar një informacion më të hollësishëm lidhur me cilësinë e punës audituese.

Në vijim paraqitet shkurtimisht analiza e punës të departamenteve të auditimit.

DEPARTAMENTI I METODOLOGJISË, STANDARDEVE DHE SIGURIMIT TË CILËSISË SË AUDITIMIT

Analiza e punës së vitit 2020 të Departamentit të Metodologjisë, Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë së Auditimit u fokusua në aktivitetin vjetor të dy drejtorive përbërëse, asaj të Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë, si dhe Drejtorisë së Metodologjisë e Zhvillimit. Në analizë u prezantua puna e kryer nga ky departament për vitin 2020, ku gjatë këtij viti janë shqyrtuar dhe dhënë mendime për 69 auditime të evaduara që i përkasin 7 departamenteve, duke shtuar dhe një numër auditimesh në proces riauditimi dhe evadimi. Në përgjithësi janë analizuar dhe shqyrtuar elementë të formës/strukturës, përmbajtjes dhe afateve për fazat që nga planifikimi i projektit të auditimit deri në hartimin e Raportit përfundimtar dhe të Projektvendimit për në vijim të evadimit të auditimit. Në mënyrë të përmbledhur u reflektuan konstatimet nga shqyrtimet e dosjeve për të gjitha llojet e auditimeve. Në përfundim u paraqitën objektivat për vitin 2021 me qëllim shmangien e mangësive të konstatuara në funksion të përmirësimit të cilësisë së veprimtarisë audituese të KLSH, si më poshtë:

- Rritjen e përgjegjshmërisë në veprimtarinë e saj për kontrollin e cilësisë së auditimit;
- Forcimin dhe konsolidimin e Drejtorisë, me qëllim ngritjen në një nivel më të lartë të veprimtarisë kontrolluese për cilësinë e auditimit;
- Zbatimin e plotë të Rregullores së Procedurave të auditimit, Manualeve përkatëse të auditimit zbatimin në mënyrë të dokumentuar të Udhëzuesit për menaxhimin e cilësisë së auditimit;
- Kombinimin e kontrollit të cilësisë gjatë procesit auditues (në të nxehtë) me kontrollin e plotë të dosjeve të auditimit të evaduara (në të ftohtë), për të krijuar një kuadër të plotë dhe të gjithanshëm mbi cilësinë e auditimit;
- Trajnimin e vazhdueshëm dhe për çështje specifike të zbatimit të standardeve, manualeve dhe kuadrit rregullator për auditimet sipas llojeve.

Drejtoria e Metodologjisë dhe Zhvillimit, në prezantimin e saj, u fokusua në disa drejtime:

- Koordinimit të punës, për përmirësimin e manualeve të auditimit; ku janë rishikuar dhe përditësuar manualët e Auditimit të Përputhshmërisë dhe të Auditimit Financiar, janë në proces finalizimi Manuali i Auditimit të Performancës, Manuali i ndjekjes së zbatimit

të rekomandimeve, Rregullorja e Procedurave të Auditimit dhe Udhëzuesi “Për Auditimin e Parandalimit të Korrupsionit”.

- Kryerjen e trajnimeve, mbi përditësimin e audituesve me ndryshimet si më sipër; për këtë, gjatë vitit 2020, janë realizuar 4053 ditë trajnimi në total, nga 142 auditues, ose 28,5 ditë trajnimi për auditues. Objektivi, 25 ditë trajnimi, për çdo auditues, është realizuar. Për shkak të përballjes globale me Pandeminë Covid-19, Drejtoria e Metodologjisë dhe Zhvillimit, pati një qasje të re në realizimin e trajnimeve duke u fokusuar në realizimin e tyre nëpërmjet platformave online.
- Këshillimin e audituesve, sipas kërkesave të tyre.

Gjithashtu u paraqitën tre objektiva kryesore për periudhën afatmesme, si më poshtë:

- Hartimi i strategjisë së Zhvillimit Profesional (*proces i nisur*);
- Hartimi i një database, mbi edukimin profesional të audituesve të KLSH-së, me qëllim një adresim sa më të mirë, të aftësive dhe kompetencave të tyre profesionale në drejtim të auditimit;
- Ndërtimin e gjurmës së auditimit dhe hartës së proceseve, mbi auditimin e drejtimeve kryesore të auditimit, duke iu referuar specifikave dhe fushës së auditimit të çdo departamenti.

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË INSTITUCIONEVE QENDRORE (DAIQ)

DAIQ paraqiti rezultatet e arritura, nën dritën e objektivave të Departamentit për vitin 2020, referuar treguesve statistikorë. Megjithë situatën e vështirë të krijuar nga pandemia botërore Covid-19, Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore gjatë vitit 2020 realizoi 14 auditime, nga 26 auditime të realizuara një vit më parë. Veprimtaria audituese e departamentit ishte shtrirë në 14 institucione, në zbatim të standardeve të auditimit financiar (ISSAI 2000-2899) dhe atij të përputhshmërisë (ISSAI 4000). Në përfundim të tyre është konkluduar në 4 opinione financiare dhe 9 opinione përputhshmërie.

Për gjetjet e konstatuara në këto auditime, DAIQ ka dhënë 151 rekomandime me qëllim përmirësimin e legjislacionit dhe sigurimin e zbatimit të kuadrit ligjor, rregullator, dhe parimeve të menaxhimit të shëndoshë financiar. Si pasojë e shkeljeve të disiplinës financiare në total për vitin 2020, janë konstatuar gjithsej 705,424 mijë lekë shpenzime me efekte negative në buxhetin e shtetit, nga të cilat: 243,655 mijë lekë dëm ekonomik dhe 461,769 mijë lekë menaxhim jo efektiv fondesh. Për shkeljet e konstatuara, DAIQ ka kërkuar ndërmarrjen e masave nga institucionet përgjegjëse, me qëllim zhdëmtimin dhe eliminimin e efekteve negative financiare në buxhetin e shtetit. Vëmendje e veçantë gjatë aktivitetit të kryer nga DAIQ, i është kushtuar edhe trajtimit të ankesave, ku gjatë vitit 2020 janë administruar 35 të tilla, prej të cilave 7 janë trajtuar me auditime tematike, ose përcjellë dhe trajtuar çështja e plotë, në auditimet e nisura.

Në përfundim u paraqitën objektivat për vitin 2021 si më poshtë:

- Hartimi dhe përditësimi e një bazë të dhënash për institucionet e audituara ku të dokumentohen të dhëna lidhur me riskun institucional;
- Kryerjen e auditimeve të përbashkëta me Departamentin e Auditimit të IT, forcimin e bashkëpunimit me Departamentin e Sigurimit të Cilësisë, apo me Departamentet e tjera të KLSH, si ai i Auditimit të Buxhetit të Shtetit;

- Zhvillimin e kapaciteteve të stafit të DAIQ nëpërmjet trajnimeve brenda dhe jashtë vendit, etj.
- Në fokus të aktivitetit të departamentit për vitin 2021 do të jetë auditimi i shpenzimeve të kryera nga buxheti i shtetit për situatën e krijuar nga tërmeti dhe pandemia botërore Covid-19, si çështje me ndjeshmëri të lartë publike.
- Kontrollat e brendshme të institucioneve do të jenë gjithashtu në fokus pasi forcimi i tyre do të ndikonte pozitivisht performancën e subjekteve në menaxhimin e fondeve publike.

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË BUXHETIT TË SHTETIT (DABSH)

Analiza e DABSH u fokusua në paraqitjen e rezultateve të Departamentit, evidentimin e problematikave, dobësive dhe sfidave të ardhshme. Duke cilësuar vitin 2020 si një vit të veçantë dhe të vështirë për shkak të pandemisë Covid-19, që u shoqërua me përballje me kushtet e reja të punës në kushtet e izolimit dhe të distancimit social në vijimësi, u theksua se pavarësisht nga këto, Departamenti ka arritur të realizojë auditimet në funksion të përmbushjes së detyrimit ligjor të KLSH-së, për dhënien e mendimit mbi zbatimin e buxhetit faktik 2019. Kështu, gjatë vitit 2020, DABSH ka evaduar 11 auditime në total, prej të cilave 9 auditime të parashikuara në planin vjetor, 2 auditime të mbartura nga viti 2019.

Një risi e sjellë në planin e auditimeve dhe realizuar gjatë vitit 2020 ishte dhe kryerja e një auditimi performance në bashkëpunim me Departamentin e Auditimit të Performancës me temë “Ecuria e borxhit tatimor” për periudhën kohore 2017-2019.

Në 11 auditime të evaduara në vitin 2020, në varësi të llojit të auditimit janë dhënë 9 opinione, 8 prej të cilëve në auditime përputhshmërie dhe 1 në auditim financiar. Për sa i përket llojit të opinionit, në vlerësim të situatës, materialitetit dhe përhapjes së parregullsive të konstatuara dhe impaktit të tyre në miradministrimin e financave publike, KLSH ka dhënë:

- 6 Opinione të Kundërt;
- 1 Opinion të Pakualifikuar me theksim të çështjes;
- 2 Opinione të Kualifikuar.

Për vitin 2020, në auditimet e kryera janë lënë gjithsej 254 rekomandime, ku masat organizative kanë peshën më të madhe në numrin total të rekomandimeve të lëna me rreth 56%, ndjekur nga masat e dhëna në lidhje me veprime të kryera në kushtet e parregullsive ligjore me efekte negative për buxhetin e shtetit, prej rreth 19%.

Në përfundim u paraqitën objektivat për vitin 2021 si më poshtë:

- Rritjen e kapaciteteve audituese veçanërisht në auditimet specifike në fushën e tatimeve dhe doganave;
- Rritjen e mbulimit me auditim të njësive buxhetore me objektiv rritjen e auditimeve financiare;
- Rritja e numrit të auditimeve të performancës mbi efektivitetin e programimit dhe zbatimit buxhetit.

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE (DAVQV)

Analiza e departamentit u përqendrua kryesisht në auditimet e kryera, të cilat kanë pasur për qëllim që, nëpërmjet gjetjeve dhe rekomandimeve të lëna në përfundim të çdo auditimi, të minimizojnë eliminimin e parregullsive duke dhënë ndikim pozitiv në përmirësimin e punës të subjekteve të audituara. Për vitin 2020 nga 29 auditime të programuara/planifikuara janë të realizuara dhe evaduar 18 auditime, si dhe janë në proces evadimi 9 subjekte.

Nga auditimi i 12 subjekteve për aktivitetin auditues të KLSH-së gjatë vitit 2020, nga DAVQV është konstatuar dëm ekonomik, për shpenzimet dhe të ardhurat në vlerën gjithsej 167,708 mijë lekë, nga te cilat: vlera 1,740 mijë lekë në fushën e pagave (Ilog. 601), në vlerën 2,981 mijë lekë në shpenzime operative (Ilog 602), në vlerën 41,736 mijë lekë në fushën e zbatimit të kontratave të punëve publike dhe mos zbatimin në afat të kontratave (Ilog. 231), në vlerën 63,363 mijë lekë në të ardhurat nga taksat e tarifat vendore dhe në vlerën 57,889 mijë lekë, në zbatimin e procedurave të prokurimit, si diferencë oferte midis operatorëve ekonomikë të shpallur fitues dhe operatorëve ekonomikë të skualifikuar por me ofertë ekonomike më të leverdishme, në mospërputhje me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik.

Për vlerën shpërblim dëmi prej 167,708 mijë lekë, janë rekomanduar gjithsej 64 masa, të cilat janë rekomanduar për t'u zhdëmtuar e gjithë vlera, në përqindje ndaj totalit sipas natyrës së shpenzimit.

Janë rekomanduar 161 masa organizative; 90 masave disiplinore, 24 masa administrative. Është bërë 1 kallëzim penal për 1 subjekt për konsumim të veprave penale gjatë ushtrimit të detyrës si dhe 1 vlerësim për kallëzim penal, të cilat i janë dërguar organit prokurorisë. Kallëzimi është bërë për konsumimin e figurës së veprës penale të "Të shkeljes së barazisë në tendera apo ankande publike", parashikuar nga neni 258 i Kodit Penal dhe "Falsifikim i dokumenteve" neni 186 i Kodit Penal.

Nga DAVQV janë trajtuar edhe 69 ankesa/denoncime/shkresa, nga shqyrtimi i tyre ka rezultuar se kryesisht ankesat e drejtuar janë kompetencë e KLSH-së.

Gjatë vitit 2020, edhe pse në kohë pandemie, Departamenti ka treguar kujdesin dhe përkushtimin e duhur, që në zbatim të standardeve të marrë pjesë në mënyrë sistematike në të gjitha trajnimet e realizuara nga KLSH, por dhe institucione të tjera brenda vendit apo edhe jashtë. Rezultati i kësaj pune vjetore është se çdo auditues jo vetëm ka plotësuar objektivin e trajnimeve, 20 ditë trajnimi/vit, por dhe ka përditësuar njohuritë e fituara për secilën fushë.

Në përfundim u paraqitën objektivat për vitin 2021 si më poshtë:

- Përsosja e përmbajtjes së programit vjetor të auditimit dhe ndjekja e zbatimit të tij në njësitë publike të parashikuara. Forcimi i analizës së riskut si mjeti kryesor në vlerësimin dhe përzgjedhjen e subjekteve për auditim.
- Kryerja e auditimeve në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit dhe praktikat më të mira evropiane të auditimit, si dhe përmirësimi i mëtejshëm cilësor i tyre.
- Sinergjizimi i veprimtarisë së Departamentit dhe KLSH-së në përpjekjet strategjike të përbashkëta në luftën kundër korrupsionit, realizimin e auditimeve cilësore rritjen e transparencës dhe të bashkëpunimit me institucionet publike.

Për periudhën tre vjeçare (2021 -2024):

- Zhvillimi i burimeve njerëzore në nivelin e parametrave të kërkuar nga standardet e INTOSAI dhe rritja e profesionalizmit të stafit auditues nëpërmjet realizimit të trajnimeve për stafin sipas normave të vendosura 2 vitet e fundit për ditë trajnimi në vit.
- Menaxhimi efikas i burimeve financiare dhe materiale të KLSH, konform kërkesave ligjore.
- Përditësimi i strategjisë së menaxhimit të riskut, ndjekja e zbatimit të tij, si dhe miratimi i gjurmës së auditimit.
- Grumbullimi dhe shfrytëzimi i ekspertizës më të mirë të fushës, nëpërmjet ndjekjes dhe zbatimit të marrëveshjeve të lidhura me organizatat e audituesve, kontabilistëve dhe me ekspertët kontabël.
- Konsolidimi i komunikimit dhe bashkëpunimit me Kuvendin e Shqipërisë si partneri kryesor i KLSH-së, dhe ku institucioni raporton lidhur me përgjegjshmërinë qeveritare të përdorimit të burimeve publike.
- Zhvillimi i mëtejshëm i bashkëpunimit me aktorët jashtë vendit, përkatësisht me organizatat ndërkombëtare të auditimit si INTOSAI dhe EUROSAI, me SAI-t homologe të vendeve të BE-së, të vendeve të rajonit dhe në veçanti me Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës, duke shtuar veprimtarinë e trajnimeve dhe shkëmbimit të eksperiencës, si dhe duke kryer edhe auditime të përbashkëta apo paralele, si në fushën e auditimit mjedisor etj.
- Përmirësimi në vijimësi i transparencës në marrëdhëniet me publikun, me mediat dhe organizatat jo-fitimprurëse që luftojnë korrupsionin.
- Shtimi i pranisë së audituesve me informacione dhe mesazhe në median vizive dhe të shkruar të vendit.

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT ZHVILLON ANALIZËN VJETORE PËR VITIN 2020

Departamenti i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit zhvilloi analizën për vitin 2020, e cila mbulon subjektet si Agjencia Shtetërore e Kadastrës me drejtoritë vendore vartëse dhe institucionet e mjedisit. Analiza u konceptua në formën e një forumi, ku prezantimi i arritjeve të departamentit u gërshetua me identifikimin e mangësive dhe pengesave me të cilat është ndeshur ky departament gjatë punës audituese në vitin 2020, veçanërisht në kontekstin e ri ligjor të funksionimit dhe menaxhimit të pronave në Shqipëri. Për vitin 2020 janë kryer dhe evaduar 8 auditime, e ndikuar kjo edhe nga pengesat e krijuara nga pandemia Covid-19.

Nisur nga gjetjet, janë propozuar 311 masa nga të cilat: 231 masa organizative; 27 masa zhdëmtuese me vlerë 1,004,835 mijë lekë; 5 masa me 3E organizativo-zhdëmtimi me vlerën 90,123 mijë lekë; 48 masa disiplinore; 1 kallëzim penal. Një vend të veçantë në punën e Departamentit zënë edhe ankesat e qytetarëve. Peshën kryesore të ankesave që janë brenda kompetencave të KLSH, e zënë ato në lidhje me pronësinë, të cilat përbëjnë 80 %, dhe pjesa tjetër 8% për probleme të ndërtimeve pa leje lidhur me institucionet si Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, Bashki të ndryshme, 8% kërkesa për vënie në dispozicion të raporteve përfundimtare të auditimit, 4% për probleme mjedisore. Konkretisht, nga Departamenti i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit gjatë vitit 2020 janë administruar 136 ankesa.

Në përfundim u paraqitën objektivat për vitin 2021 si më poshtë:

- Hartimi i udhëzuesit për qasjen në përzgjedhjen e subjekteve për tu audituar, bazuar në një vlerësim sistematik dhe të dokumentuar të riskut dhe materialitetit, kryesisht të atij cilësor, kjo nisur edhe nga auditimet që kryhen në institucionet e kadastrës;
- Përgatitja e moduleve të trajnimit të audituesve mbi auditimin e përputhshmërisë.
- Eksplorimi i mundësive për auditime të përbashkëta dhe/ose paralele me SAI-t partnere të KLSH dhe SAI-t e tjera evropiane e më gjerë, kryesisht në auditime të subjekteve mjedisore, duke qenë edhe në të njëjtën linjë me objektivin 15 për zhvillimin e qendrueshëm të axhendës 2030 të OKB;
- Rritja e numrit të rekomandimeve për përmirësime ligjore në auditimet e institucioneve të kadastrës dhe të mjedisit;

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE DHE INVESTIMEVE TË HUAJA (DAISHIVH)

Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja zhvilloi analizën vjetore të punës së vitit 2020, duke u bazuar në këto drejtime: Veprimtaria audituese/numri i auditimeve të zhvillura, Shprehja e gjetjeve me gjuhë statistikore, Evidentimi i auditimit më të mirë dhe më të dobët, Identifikimi i dobësive të shfaqura gjatë vitit 2020, Prezantimi i tre auditimeve, Veprimtari të tjera të Departamentit, Objektivat për vitin 2021.

Për vitin 2020, ky Departament ka realizuar 9 auditime. Nga këto, 6 auditime janë me objekt përputhshmërinë mbi aktivitetin ekonomiko-financiar (4 janë auditime të realizuara në Shoqëri Publike dhe 2 janë auditime të realizuara për projekte me financime të huaja) një është auditim i realizuar për zbatim rekomandimesh për auditimet e evaduara në vitin 2019, një auditim tematik në Spitalin Rajonal Vlorë dhe një vendim mbi kthim për riauditim të projektit “Rehabilitimi i rrugës së lumit të Vlorës”.

Të gjitha auditimet kanë qenë me objekt përputhshmërie dhe kanë pasur si qëllim, që nëpërmjet gjetjeve të konstatuara dhe rekomandimeve të lëna në përfundim të tyre, të ndihmojnë subjektet e audituara në shmangien në vazhdimësi të parregullsive dhe të kenë ndikim pozitiv në përmirësimin e veprimtarisë së subjekteve të audituara.

Gjatë vitit 2020 auditimet e evaduara janë raportuar për pasqyrim në evidencat e përgjithshme të institucionit, e në mënyre të përmbledhur rezultojnë si vijon:

Numri i auditimeve të evaduara është 9, nga të cilat, 6 auditime përputhshmërie (4 janë auditime të realizuara në shoqëri publike dhe 2 janë auditime të realizuara për projekte me financime të huaja), 1 është auditim i realizuar për zbatim rekomandimesh, 1 auditim tematik dhe 1 vendim mbi kthim për riauditim. Nga 6 auditime të përputhshmërisë 4 janë auditime në shoqëri publike dhe 2 auditime të projekteve me financime të huaja. Për auditimet e përputhshmërisë në vitin 2020 janë dhënë tre opinion të kundër, një opinion i kualifikuar, një opinion i modifikuar dhe nuk është dhënë opinion për një auditim. Dëmi ekonomik i konstatuar dhe rekomanduar për tu zhdëmtuar është në shumën 112,520 mijë lekë (107,320 mijë lekë në shoqëritë publike dhe 5,200 mijë lekë në projektet me investime të huaja), në 14 masa të rekomanduara. Efekti Negativ Financiar në shumën 500,898 mijë lekë (95,358 mijë lekë në shoqëritë publike dhe 405,540 mijë lekë në projektet me investime të huaja), në 14 masa të rekomanduara. Janë rekomanduar masa organizative 177 gjithsej, masa administrative 5, Masa disiplinore gjithsej 43. Kallëzimet penale/indicie për vitin 2020 janë në dy raste. Gjithashtu theksi u vu edhe në objektivat që vijnë si kërkesë nga BE; rritjen e numrit të auditimeve financiare dhe ato të performancës dhe auditimi

i fondeve të akorduara për përballimin e pandemisë Covid-19 si dhe fondet për trajtimin e dëmeve të shkaktuar nga tërmeti.

Në përfundim u paraqitën objektivat për vitin 2021 si më poshtë:

- Rritja e impaktit të punës audituese me fokus 6E-të (ekonomicitetin, eficiencën, efektivitetin, etikën, mjedisin (environment) dhe energjinë);
- Auditimi mbi bazë risku – qasje efektive e auditimit;
- Konsolidimi i Auditimit të Përputhshmërisë vlerësuar sipas kërkesave të ISSAI-ve si prioritet i KLSH;
- Kryerjen e auditimeve në përputhje me standardet e auditimit dhe me praktikat me të mira të auditit;
- përvetësimin e standardeve ISSAI dhe manualit të auditimit në zbatim “Rregullores së procedurave të auditimit”;
- rritja e kapaciteteve audituese dhe profesionale në dhënien e opinionëve për auditimet e përputhshmërisë; realizimi i punës audituese me cilësi dhe brenda afateve të përcaktuara, duke respektuar etikën në punë;
- forcimi i marrëdhënieve me kolegët duke rritur përpjekjet dhe gadishmërinë për të punuar dhe bashkëvepruar në grup; përdorimi në mënyre sistematike dhe në kohe reale i programit rev/zone;
- pasqyrimi i çdo faze të auditimit në këtë sistem sipas detyrimit të çdo audituesi, etj.

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS

Departamenti i Performancës zhvilloi analizën vjetore të punës së vitit 2020, duke u bazuar në auditimet e zhvilluara gjatë një viti. Departamenti i Auditimit të Performancës ka realizuar 16 auditime nga të cilat u evaduan 8 auditime. Tetë auditimet e evaduara vetëm për vitin 2020 u kryen në mbi 27 subjekte, duke gjeneruar 288 gjetje, 189 konkluzione dhe 200 rekomandime. Mesatarisht për çdo auditim u realizuan 36 gjetje, 23 konkluzione dhe 25 rekomandime, shifra këto pak a shumë të njëjta me një vit më parë. Nga pikëpamja e 3e-ve, për vitin 2020 janë adresuar 54 gjetje, 34 konkluzione dhe 43 rekomandime për eficiencën, si dhe 234 gjetje, 155 konkluzione dhe 157 rekomandime për efektivitetin.

Në pjesën më të madhe të rasteve, auditimet e performancës KLSH janë fokusuar në hartimin dhe zbatimin e strategjive, plotësimin dhe përditësimin e kuadrit ligjor e rregullator, përmirësimin e aktiviteteve të subjekteve të audituara sipas praktikave të mira bashkëkohore ndërkombëtare. Auditimet e Performancës për nga natyra janë të prirura të kenë një qasje më shkencore se llojet e tjera të auditimeve, gjë e cila është ofruar edhe në auditimet e performancës që KLSH ka realizuar në vitet e fundit.

Në këtë analizë u prezantuan edhe Objektivat e 2021 si më poshtë:

- Realizimi dhe evadimi i 15 raporteve të auditimeve të performancës në përputhje me vendimin nr. 138 të Kryetarit të KLSH-së datë 30.12.2020 “Për miratimin e programit të veprimtarisë audituese të KLSH-së për vitin 2021”.
- Auditimi për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2020. Ky auditim është parashikuar për tu zhvilluar në Korrik 2021 në përputhje me Manualin e Zbatimit të Rekomandimeve.
- Plotësimi i Manualit të Auditimit të Performancës i miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 78 datë 30.06.2020, i cili në varësi të ngarkesës së departamentit mund të shtrihet edhe për vitin tjetër.

- Vazhdimi dhe rritja e bashkëpunimeve me SAI-t ndërkombëtare, botën akademike, universitetet, OJF-të, ekspertë të fushave në të cilat vepron Departamenti.
- Organizimi i **workshopeve** të përbashkëta me palët e interesit për shkëmbimin e eksperiencave dhe njohurive të fituara gjatë auditimeve të realizuara përgjatë viteve.
- Prezantimi i disa auditimeve në mjediset universitare në varësi të çështjeve dhe problematikave të trajtuara.

DEPARTAMENTIT I AUDITIMIT TË TEKNOLOGJISË SË NFORMACIONIT

Departamenti i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit zhvilloi analizën vjetore për vitin 2020 bazuar në katër kolona kryesore:

1. Baza ligjore dhe metodologjia e auditimit TI.
2. Burimet njerëzore të auditimit TI.
3. Auditimet e Teknologjisë së Informacionit gjatë vitit 2020 dhe dobësitë e vërejtura.
4. Vizioni për auditimet TI dhe objektivat për të ardhmen.

DATI gjatë vitit 2020 planifikoi kryerjen e 10 (dhjetë) Auditimeve nga të cilat 7 (shtatë) auditime të sistemeve TI, 2 (dy) auditime performance me temë TI dhe 1 (një) auditim tematik për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme TI.

Në auditimet TI të zhvilluara gjatë vitit 2020 për çdo auditim të kryer janë mbuluar mesatarisht 5 subjekte nga rreth 3 të një viti më parë.

Nga auditimet e kryera konstatohet se 82% të gjetjeve janë për fushat e Qeverisjes TI dhe Sigurisë së Informacionit të cilat kanë një rol të madh në ngritjen e funksionimit të sistemeve TIK, çka tregon një planifikim të drejtë të kryer nëpërmjet analizës së riskut me manualin aktiv të auditimit TI.

Më pas pjesëmarrësit zhvilluan një diskutim mbi aspekte të dijeve dhe certifikimit të punonjësve të Departamentit TI.

Departamenti TI, prezantoi auditimin më të mirë të përzgjedhur nga auditimet e zhvilluara gjatë vitit 2020, e pikërisht auditimin e Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit në Institutin e Gjeoshkencave, Ujit dhe Mjedisit.

Në këtë analizë u prezantuan edhe Objektivat e 2021 si më poshtë:

- Përvetësimi dhe përdorimi në auditim i teknikave CAAT, IDEA, COBIT, si dhe thellimi i njohurive në fushën e teknologjisë së informacionit.
- Mbështetjen nga Departamenti i TI-së të auditimeve të përputhshmërisë, financiare dhe të performancës për problematikat e fushës TI-së.
- Pajisja e audituesve IT me certifikata të fushës, të njohura ndërkombëtarisht, duke marrë në konsideratë burimet e nevojshme sipas angazhimeve financiare.
- Thellimi i përdorimit të Manualit Aktiv të auditimit IT për analizën e riskut dhe Auditimi i Sistemeve IT që menaxhojnë fusha me risk si: prokurimet publike, katastrofat natyrore.

DEPARTAMENTI JURIDIK

Analiza vjetore e punës së Departamentit Juridik u zhvillua nën frymën e angazhimeve dhe në zbatim të kërkesave të: ISSAI 1, Deklaratës së Limës, neni 16 i saj "Raportimi në Parlament dhe ndaj publikut të gjerë", të ISSAI 12 "Vlerat dhe dobitë e SAI-ve: të bësh ndryshimin në jetën e

qytetarëve”, Parimi 4 “Raportimi mbi rezultatet e auditimit, duke mundësuar publikun për të mbajtur qeverinë dhe subjektet e sektorit publik të përgjegjshëm”, të ISSAI 20 “Parimet e transparencës dhe të përgjegjshmërisë”.

Departamenti Juridik bëri një pasqyrim analitik të punës dhe angazhimit institucional përgjatë vitit 2020. Ky prezantim u fokusua në çështjet më sensitive dhe problematikat e evidentuara gjatë ushtrimit të detyrave funksionale që departamenti ushtron, në bazë dhe për zbatim të Rregullores së Brendshme të KLSH-së, miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH-së nr. 85 datë 30.06.2015, e ndryshuar.

Në kuadër të konsulencës juridike, Departamenti Juridik ka ruajtur kontaktet me institucionin e Prokurorisë së Përgjithshme, SPAK dhe Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore, në lidhje me ecurinë e procedimeve të filluara në vijim të referimeve penale. Në rastet kur ka qenë i nevojshëm interpretimi ligjor, nëpërmjet kontributit të tij profesional, Departamenti Juridik ka asistuar Departamentet e Auditimit në trajtimin e korrespondencës me institucione dhe qytetarë, në lidhje me çështjet me natyrë ligjore e juridike. Njëkohësisht, ka asistuar gjithashtu në mënyrë proaktive në ndjekjen e Planit të Veprimit për Zbatimin e Strategjisë së Zhvillimit të KLSH 2018 – 2022, si dhe në vijimësi dhe në kuadër të iniciativës së ndërmarrë në vitin 2018, me qëllim përafrimin e legjislacionit kombëtar me atë të BE, është angazhuar aktualisht në ngritjen e një grupi pune, në zbatim të urdhrat të Kryetarit nr. 131, datë 23.12.2020 "Mbi ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e amendimeve të ligjit ", për disa ndryshime në ligjin nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Në kuadër të kallëzimeve penale dhe ndjekjes së proceseve gjyqësore, gjatë vitit 2020 KLSH ka dërguar në organin e prokurorisë 8 referime penale, për 12 drejtues të nivelit të lartë të mesëm dhe specialist.

Gjithashtu, për vitin 2020 KLSH është angazhuar në 97 procese gjyqësore, nga të cilat 24 procese gjyqësore të karakterit penal, 59 procese gjyqësore të karakterit administrativ dhe 14 procese gjyqësore të karakterit civil. Këto procese kanë pasur një shpërndarje të madhe gjeografike, ku përfshihen gjykata si Tiranë, Durrës, Kavajë, Lushnje, Fier, Vlorë, Sarandë, Pogradec, Elbasan, Gjirokastër, Lezhë, Shkodër, Kukës, Pukë, Tropojë, Korçë.

Vlen të theksohet se gjatë vitit 2020 janë të shumta edhe vendimet gjyqësore të cilat kanë konfirmuar rekomandimet e lëna nga KLSH në subjektet e audituara. Për rrjedhojë, gjykatat e shkallës së parë në 21 vendime të dhëna kanë konfirmuar rekomandimet e gjetura nga KLSH në auditimet e zhvilluara, nga të cilat, deri më tani 4 prej tyre kanë marrë formë të prerë dhe janë konfirmuar edhe nga gjykatat e apelit. Në kuadër të proceseve gjyqësore, KLSH ka insistuar në mënyrë proaktive dhe sistematike në monitorimin e zbatimit të rekomandimeve, arkëtimit të dëmit dhe parandalimit të efekteve negative financiare. Në kuadër të angazhimit të KLSH-së për integrimin europian, Departamenti Juridik është angazhuar në mënyrë proaktive për ofrimin e asistencës dhe konsulencës juridike, duke përgatitur përgjigjet e KLSH-së për pyetjet e Pyetësorit të BE sipas metodologjisë së kërkuar dhe brenda afateve të përcaktuara, si dhe duke mbajtur marrëdhënie intensive me Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Financave dhe partnerët në Komisionin Europian.

DREJTORIA E AUDITIT TË BRENDSHËM (DAB)

Auditimi i Brendshëm në Kontrollin e Lartë të Shtetit ka për mision të japë siguri objektive dhe të ofrojë këshillim për menaxhimin për të shtuar vlerën e për të përmirësuar veprimtarinë e KLSH-së. Auditimi i Brendshëm ndihmon KLSH-në për të arritur objektivat, nëpërmjet një

veprimtarie të disiplinuar dhe sistematike, për të vlerësuar e përmirësuar frytshmërinë e menaxhimit të riskut, si dhe proceset e kontrollit e të qeverisjes.

Në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 114, datë 22.10.2015 "Për auditin e brendshëm në sektorin publik" dhe të kapitullit III, të Manualit të Auditimit të Brendshëm miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave, nr.100, datë 25.10.2016 "Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar, veprimtaria audituese është orientuar në vlerësimin e përshtatshmërisë dhe efektivitetin e sistemeve të kontrolleve.

Kryerja e angazhimeve të auditimit të brendshëm është bërë në zbatim të Planit Vjetor të Auditimit të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm i miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me Vendimin nr.130, datë 21.10.2019 "Për miratimin e planit të punës për vitin 2020 për Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm", ndryshuar me vendimin nr. 104, datë 23.10.2020, "Për një ndryshim në vendimin nr.130, datë 21.10.2019 "Për miratimin e planit të punës për vitin 2020 për Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm". Për vitin 2020 u planifikuan 5 misione auditimi me bazë sistemi.

Nga 5 misione auditimi të planifikuara të përfundonin vetëm 3 misione, ndërsa 2 misione auditimi janë në proces dhe do të përfundojnë në gjysmën e dytë të muajit mars 2021. Gjithashtu ka përfunduar edhe misioni i auditimit të sistemeve dhe përputhshmërisë financiare në KLSH për vitin 2019 i cili është raportuar si mision që ka filluar në vitin 2019 dhe ka përfunduar në muajin mars të vitit 2020.

Referuar sa më sipër mund të themi se për vitin 2020 ka përfunduar një auditim për llogari të vitit 2019, tri auditime të planifikuara për vitin 2020 dhe janë në proces dy misione auditimi të filluara në dhjetor të vitit 2020, misioni i auditimit të Sektorit të Shërbimeve dhe misioni i auditimit të Sektorit të Financës të parashikuara të përfundojnë në mesin e muajit mars 2021.

Në këtë analizë u prezantuan edhe Objektivat e 2021 si më poshtë:

- Mbulimi me auditim i njësive që janë në fushën e veprimtarisë, si dhe të minimizohet mbivendosja, janë marrë në konsideratë një sërë aspektesh/prioritetesh si:
 - Mbulimi i të gjitha njësive organizative me auditim.
 - Shmangia e mbivendosjeve.
 - Rreziqet kyçe që kërcënojnë fushën apo fushat nën planifikim.
 - Çdo rrezik tjetër kyç i identifikuar nga ana e menaxhimit.
 - Plotësimi dhe administrimi i burimeve të auditimit.
- Auditimi bazuar në faktorët e riskut;
- Auditim i njësive që nuk janë audituar për një kohë të gjatë edhe rezultojnë me risk të mesëm apo të ulët.

DREJTORIA E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit në zhvilloi në ambientet e Kontrollit të Lartë të Shtetit, analizën vjetore të punës të vitit 2020, duke u fokusuar në këto drejtime:

- Fuqitë dhe dobësitë e drejtorisë në aspektin ligjor dhe rregullativ.
- Fuqitë dhe dobësitë e drejtorisë në aspektin organizativ.
- Fuqitë dhe dobësitë e drejtorisë në aspektin financiar.
- Fuqitë dhe dobësitë e drejtorisë në aspektin komunikues.

- Mundësitë për përmirësim dhe risqet në të gjitha sa përmendur më sipër.

Qasja strategjike e KLSH-së për krijimin e një ambienti bashkëkohor të IT ka konsistuar në orientimin e buxheteve të investimeve në instalimin e platformave IT në funksion të modernizimit të menaxhimit të proceseve të auditimit dhe atyre logjistike mbështetëse.

Gjatë ushtrimit të detyrave funksionale të institucionit, si rezultat i intensitetit të lartë të punës, gjatë proceseve të auditimit dhe atyre administrative, gjenerohet një fluks i madh informacioni, i cili duke u konsideruar si një aset i çmuar i institucionit dikton domosdoshmërinë për kontroll, përpunim dhe ruajtjen e integritetit dhe disponueshmërisë së tij.

Nisur nga sa më sipër, në këtë analizë u prezantua puna e kryer nga Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit përgjatë vitit 2020, në mbështetje të procesit auditues, e cila kryesisht ka konsistuar në:

- Dhënien e mbështetjes teknike për përdorimin e sistemit të informacionit SIMMPA.
- Realizimin e trajnimeve të brendshme në lidhje me teknologjinë e informacionit në përgjithësi dhe me sistemin e informacionit SIMMPA në veçanti për stafin auditues, në bashkëpunim me Departamentin e Metodologjisë dhe Standardeve.
- Përdorimin e praktikave dhe metodave më të mira, në funksion të krijimit të kushteve optimale në mbështetje të procesit auditues, duke krijuar linjën e parë mbështetëse në lidhje me teknologjinë e informacionit për të gjithë stafin e KLSH.
- Mirëmbajtjen e një ambienti teknologjik që i përshtatet nevojave dhe kërkesave të institucionit.
- Bashkëpunimin midis punonjësve të drejtorisë me njëri-tjetrin dhe me strukturat drejtuese të institucionit.
- Hartimin dhe aplikimin e dokumenteve dhe manualeve si korniza rregullative për mirëfunksionimin e drejtorisë.

Ndër të tjera në këtë analizë u cilësua dhe fakti se përgjatë vitit 2020, vit në të cilin transmetimi i informacionit në rrugë elektronike u shumëfishua, jo vetëm për Kontrollin e Lartë të Shtetit por për çdo institucion publik si dhe privat, ashtu sikurse edhe rreziqet për sulme kibernetike, sistemet IT të KLSH garantuan disponueshmëri, integritet dhe konfidencialitet të informacionit.

Në këtë analizë u prezantuan edhe Objektivat e 2021 si më poshtë:

- Analizimi, hartimi dhe propozimi i një kuadri rregullator specifik me qëllim qartësimin e detyrave dhe përgjegjësive të Drejtorisë në raport me detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse.
- Miratimi i Planit të Rimëkëmbjes nga katastrofat.
- Krijimi i një baze të dhënash me problematikat e shfaqura, zgjidhjet e dhëna dhe rekomandimet përkatëse.
- Analizimi dhe propozimi për informatizim të disa prej proceseve administrative të institucionit.
- Propozimi dhe Zhvillimi i një procesi ITSA (IT Self Assessment)
- Përmirësimi i komunikimit ndërmjet punonjësve të Drejtorisë me njëri-tjetrin dhe me menaxhimin e lartë.

DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse sëbashku me Sektorin e Financës zhvilluan analizën vjetore për vitin 2020.

Në detyrat e saj funksionale Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse çdo vit realizon kërkesat për gjithshka ka të bëjë me nevojat e institucionit, duke filluar nga pajisjet bazike të punës. Situata jo normale nga Covid-19, bëri që drejtoria e shërbimeve mbështetëse të merrte masa për dezinfektimet e njëpasnjëshme si dhe vendosja e një impianti dezinfektues në hyrjen kryesore. Janë realizuar të gjitha riparimet brenda ambienteve të zyrave dhe godinës së KLSH-së. Për vitin 2020 janë realizuar nëpërmjet prokurimeve të gjitha blerjet e parashikuara për nevojat e institucionit. U plotësuan kërkesat e punonjësve të rinj të institucionit me kompjutera, lap-top, printera.

Në këtë analizë u prezantuan edhe Objektivat e 2021 si më poshtë:

- Të thellohet intesiviteti dhe operativiteti dhe puna e Drejtorisë të mos kuptohet si hallkë e shkëputur nga Drejtoritë e tjera.
- Plotësimi maksimal i detyrave individuale në funksion të nevojave të audituesve të KLSH-së.
- Zbatimin në maksimum të Rregullores së Brendshme e cila do të ndikojë drejtpërsëdrejti në zbatim të detyrave të përcaktuara.
- Hartim, analizim dhe propozim për një kuadër rregullator me Drejtorinë IT në funksion të regjistrimit të kërkesave për t'i paraprirë situatave të ndryshme.

Sektori i Financës, bëri një analizë të veprimtarisë për vitin 2020, duke u përqendruar në arritjet e punës në përmbushje të detyrave funksionale si: administrimin e fondeve buxhetore në dispozicion të institucionit, hartimin e projektbuxhetit vjetor, zbatimin me përpikmëri të buxhetit vjetor, mbajtjen e kontabilitetit, miradministrimin e aseteve të institucionit etj. Edhe për vitin 2021, objektiv kryesor i Sektorit të Financës, është sigurimi i mbarëvajtjes dhe funksionimit të KLSH-së, me qëllim arritjen e objektivave nëpërmjet zbatimit të detyrave që lidhen me miradministrimin dhe përdorimin me efektivitet të burimeve ekonomike, financiare dhe materiale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Sektori i Komunikimit, Botimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë zhvilluan analizën vjetore të punës për vitin 2020. Drejtoria e Burimeve Njerëzore theksoi se qëllimi i një institucioni auditues/SAI është që të përmirësojë vazhdimisht performancën e tij, dhe kjo mund të arrihet vetëm nëpërmjet një stafi i cili është i motivuar, është i mirë menaxhuar si dhe që shpërblehet në mënyrë të drejtë.

Përgjatë vitit 2020, KLSH ka vijuar të adresojë menaxhimin e burimeve njerëzore, në një linjë me objektivat e përcaktuara në Dokumentin e Politikave të Burimeve Njerëzore, miratuar me vendim të Kryetarit nr. 228, datë 31.12.2017, në drejtimet si më poshtë vijon:

- Dokumentimi dhe zbatimi i praktikave më të mira, të përshtatshme për KLSH-në mbështetur në Standardet e INTOSAI-t në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore;
- Zbatimi me rigorozitet i kuadrit rregullator ligjor të fushës;
- Sigurimi i transparencës, përgjegjshmërisë dhe qeverisjes së mirë në procesin e menaxhimit të burimeve njerëzore.
- Rekrutimi i të rinjve/individëve me rezultate maksimale të arsimimit në një ose dy degë

diplomimi, që njohin disa gjuhë të huaja, apo dhe të disponimit njëherazi të titujve akademikë, ekspertë dhe specialistë me kontribute të shquara në fusha të ndryshme si të teknologjisë së informacionit etj.

- Sigurimi i zhvillimit të vazhdueshëm profesional, zhvillimit të kapaciteteve, si dhe kryerjes së trajnimeve në mënyrë të vijueshme.

- Zhvillimi dhe zbatimi i një sistemi objektiv të vlerësimit të stafit bazuar në performancë, në përmbushjen e objektivave individuale dhe kërkesave të kompetencave profesionale, etj.

Për vitin 2020 me vendimin nr. 4, datë 27.01.2017 të Kryetarit të KLSH, "Për strukturën e renditjes së punëve, klasifikimin e vendeve të punës dhe nivelin e pagave në KLSH", i ndryshuar është miratuar struktura organike me një total prej 203 punonjësish.

Gjatë vitit 2020 janë ndjekur të gjitha procedurat sipas rregullave dhe dispozitave ligjore në fuqi mbi nëpunësin civil, për rekrutimin e 11 punonjësve, nga 16 punonjës që janë rekrutuar në vitin 2019. Për vitin 2020 përbërja e punonjësve sipas funksioneve dhe detyrave që kryejnë ka qenë: 18 personel drejtues (ku përfshihen Kryetari, Drejtori i Kabinetit, Drejtor i Përgjithshëm, Sekretar i Përgjithshëm, Drejtorët e Departamenteve e të Drejtorive, Këshilltarë) që përbën 9.5 % të numrit total faktik të punonjësve; 16 Kryeauditues që përbën 8.4 % të numrit total faktik të punonjësve; 130 Auditues (68.4 %), 19 Punonjës mbështetës (përgjegjës sektori, specialistë, juristë, asistent i Kryetarit, punonjës shërbimi) që përbën 10 % të numrit total faktik të punonjësve dhe 7 Punonjës shërbimi.

Tregues të tjerë po aq të rëndësishëm për burimet njerëzore janë moshën e punonjësve të institucionit dhe raporti femra/meshkuj gjatë 2020 përkatësisht si më poshtë:

- Moshën mesatare në KLSH në fund të vitit 2020 është 42.6 vjeç, nga 42.5 vjeç në vitin 2019.
- Vjetërsia në institucion është 8.3 vjet në vitin 2020, nga 7.7 vjet në vitin 2019.
- Shtresëzimi i trupës audituese për vitin 2020 rezultojnë 45 punonjës nën moshën 30 vjeç, nga moshën 31-50 vjeç janë 80 punonjës, ndërsa mbi moshën 51 vjeç janë 65 punonjës.

Raporti femra/meshkuj 45.2 % me 55.8% në vitin 2020, nga 45 % me 55% në vitin 2019. Rezultojnë të punësuar në institucion 85 punonjëse femra, 12 prej të cilave në pozicione drejtuese.

Spektori i Komunikimit, Botimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë u përqendrua tek komunikimi, transparenca dhe marrëdhëniet me jashtë. Gjatë vitit 2020, shtypi i shkruar ka pasqyruar raportet dhe deklaratat për shtyp të KLSH-së në një numër prej 349 artikuj, njoftime, editoriale dhe komente analitike. Për periudhën tetëvjeçare 2013-2020 nga auditues të KLSH-së janë botuar në total 925 artikuj në pothuajse të gjitha gazetatat e vendit. Për të kuptuar dinamikën, mund të përmendim se për vitin 2020, 70 auditues, nga ku rreth 20% e tyre auditues të rinj, kanë qenë prezentë pothuajse në të gjitha gazetatat me 91 shkrime. Shkrimet e audituesve përfaqësojnë fytyrën e punës sonë audituese për gjetje dhe problematika të dala gjatë auditimit duke i shërbyer drejtpërsëdrejti qytetarit.

Gjatë vitit 2020, KLSH ka trajtuar 301 letra dhe ankesa. 80 ankesa kanë qenë jashtë kompetencës dhe juridiksionit të institucionit dhe 221 ankesa në kompetencë të KLSH. Nga këto 136 janë verifikuar dhe u është dhënë përgjigje dhe 85 janë në proces verifikimi. Ankesat kryesore i

takojnë privatizimit dhe kthimit të pronës. Në kuadër të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” nga koordinatori janë trajtuar 38 letra dhe ankesa.

KLSH, në 9 vitet e fundit ka nënshkruar 63 marrëveshje bashkëpunimi, nga të cilat 36 me OJF dhe Universitete Publike e Private, 18 me institucione homologe dhe të tjerat me institucione shtetërore. Bashkëpunimi me Prokurorinë e Përgjithshme dhe Prokurorinë e Posaçme është vlerësuar maksimalisht nga KLSH, duke bashkëpunuar ngushtësisht në shkëmbimin e informacionit me qëllim evidentimin e saktë të shkeljeve, që përbëjnë vepër penale në fushën e administrimit të fondeve publike, administrimit të pronës publike dhe privatizimit të saj. KLSH në bashkëpunim me shoqatën Qëndresa Qytetare ka zhvilluar një aktivitet në të cilin janë referuar pesë auditime performance të cilat i përkasin fusha të ndryshme të veprimtarisë qeverisëse. Gjithashtu punonjës të KLSH kanë marrë pjesë edhe në aktivitete të organizuara nga organizata joqeveritare të cilat në hartimin e raporteve të tyre i janë referuar veprimtarisë së kryer nga KLSH.

Gjatë vitit 2020, Sektori i Komunikimit, Botimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë ka vijuar me sukses punën në drejtim të botimeve profesionale dhe pjesë e kolanës së botimeve prej 111 titujve i janë shtuar edhe publikimet e mëposhtme:

- Performanca e aktivitetit të KLSH-së për vitin 2019;
- Revista kërkimore shkencore, “Auditimi publik” nr.24 për periudhën shtator-dhjetor 2019, (në shqip dhe në anglisht);
- Audituesit e KLSH-së në shtypin e përditshëm (vëllimi XIII);
- Auditimi për parandalimin e korrupsionit;
- Për mirëqeverisjen e qëndrueshme;
- Analiza vjetore 2019;
- Botim për pandeminë Cov-Sars 2019.

Me synimin e përmbushjes së qëllimit të tretë të Strategjisë së Zhvillimit të KLSH-së 2018-2022, atë të forcimit të komunikimit dhe bashkëpunimit, KLSH përveç përmbushjes së detyrimit kushtetues të raportimit për zbatimin e buxhetit faktik dhe raportimit mbi performancën e institucionit ka synuar informimin e Kuvendit edhe përmes raporteve specifike, të cilat paraqesin rëndësi të veçantë për publikun. Kështu gjatë vitit 2020 KLSH i ka përcjellë Kuvendit të Shqipërisë 66 vendime dhe raporte për auditimet e kryera gjatë vitit 2020. Në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga vendimi i Kryetarit të Kuvendit, nr. 134/2018 “Për Manualin e monitorimit vjetor dhe periodik të këtyre institucioneve”, KLSH edhe gjatë vitit 2020 ka informuar Kuvendin mbi statusin e implementimit të rekomandimeve të lëna institucioneve të audituara.

Gjatë vitit 2020, për shkak të pandemisë pjesëmarrja me prezencë fizike në takime dhe trajnime ishte e mundur vetëm në dy muajt e parë të vitit 2020 dhe nga SAI-t homologe u gjetën mënyra të tjera alternative të komunikimit duke kaluar në zhvillimin e këtyre aktiviteteve online. Përfaqësues të KLSH-së gjatë vitit 2020 ka marrë pjesë në 20 aktivitete të zhvilluara jashtë vendit dhe online, në të cilat kanë marrë pjesë 28 drejtues dhe auditues me një numër total prej 76 ditë/njerëz. Për shkak të problematikave që u krijuan nga pandemia edhe fokusi i aktiviteteve të zhvilluar gjatë vitit 2020 lidhej me auditimet e kryera për shpenzimet për pandeminë Covid-19.

Në kuadër të misionit që ka Sektori i Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë në drejtim të rritjes së kanaleve të komunikimit për të ofruar transparencë në marrëdhëniet me publikun,

përgatit dhe nxjerr në mënyrë periodike programin mujor të auditimit (12 programet e auditimit për periudhën janar – dhjetor 2020) dhe buletin informativ 3-mujor të auditimit. Për vitin 2020 janë përgatitur 4 Buletinë Statistikorë, në të cilët janë pasqyruar dëmi ekonomik i konstatuar, të ardhurat e munguara dhe shpenzimet e kryera jo në përputhje me parimet e efektivitetit, eficiencës dhe ekonomicitetit (3e), përmirësimet ligjore, masat administrative, masat disiplinore dhe administrative të rekomanduara, si edhe kallëzimet penale të përcjella në Prokurori.

Në këtë analizë u prezantuan edhe Objektivat e 2021 si më poshtë:

- Hartimi i Strategjisë së Komunikimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit 2021-2023.
- Promovimi i rolit kushtetues të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe ndërgjegjësimi publik për rezultatet e auditimit nëpërmjet përgatitjes dhe publikimit të informacioneve për auditime me ndjeshmëri të veçantë për Kuvendin dhe opinionin publik.
- Intensifikimi i bashkëpunimit me organizatat jo qeveritare për promovimin e rezultateve të auditimit, me qëllim rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit për evidentimin e rasteve korruptive dhe mashtrimit me fondet publike.
- Rritja e profilit publik të KLSH-së nëpërmjet intensifikimit të bashkëpunimit me median e shkruar dhe atë audiovizive.
- Intensifikimi i komunikimit me SAI-et homologe me synim shkëmbimin e eksperiencave profesionale.
- Rritja e komunikimit të brendshëm në KLSH dhe shkëmbimit të informacionit midis Drejtorive dhe Departamenteve të auditimit.